



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME**  
Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport  
Nr.01-060/01-2828/24 datë:25.01.2024



Npi – 01/51 datë: 30.01.2024

Duke u bazuar në nenin 51.2, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, për mbledhjen e mbajtur më: 30.01.2024, nxjerr këtë:

**E K S T R A K T**  
**PROCESVERBAL**

**I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR ARSIM KULTURË RINI DHE SPORT**  
të mbajtur më datën: 30.01.2024 (e martë) në ora 09:00 h. në sallën e vogël

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja, znj.Albana Podvorica, Anëtarët e Komitetit: z.Asllan Beqaj, dhe z.Rexhep Gashi, dhe znj.Arbenita Brahimi. Në mbledhje ka munguar z.Hamëz Tërshani. Përveq anëtarëve të Komitetit në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS. Mbledhjen e hapi Kryesuesja e Komitetit, znj.Albana Podvorica, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, Konstatoi Kuorumin prej 4 anëtarëve prezent, mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

**REND DITE**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 30.08.2023,
2. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KAKRS për vitin 2024,
3. Raport i punës të KAKRS për vitin 2023,
4. Miratimi i planit të punës për vitin 2024,
5. Informate nga DKA rreth braktisjes së shkolles nga nxenesit,
6. Analize nga DKA dhe DKRS rreth realizimit të punës dhe arritjes së objektivave për vitin 2023.

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Hapi diskutimin për rendin e ditës.

**z.Asllan Beqaj;** Përshëndetje, pajtohem me rendin e ditës.

**\*Komiteti për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport, unanimisht miratoi rendin e ditës.**

**Pika 1**

**Shqyrtimi i Ekstrakt-Procesverbalit nga mbledhja e KAKRS e mbajtur më 30.08.2023**

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z.Asllan Beqaj;** Unë nuk kamë ndonjë vërejtje në procesverbal.

**\*Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin e mbledhjes të mbajtur me datë 30.08.2023.**

**Pika 2**

**Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KAKRS për vitin 2024**

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj.Arbenita Brahimi;** Neve na ka ardhë materiali, disa data i kemi caktuar por ne do të konsultohemi paraprakisht nëse do të kemi ndonjë ndryshim të datave.

**Kryesuesja, znj. Albana Podvorica;** Ne duhet me gjetë përkrahje dhe me bërë konsultimet e nevojshme për me qenë në kordinim me datat e mbledhjeve të Kuvendit.

**z. Asllan Beqaj;** Dakort jamë me diskutimet e juve. Paraprakisht ne do të diskutojmë sepse mund të kemi ndryshime, jam për me kalu orarin e propozuar.

**\*Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport, unanimsisht miratoi orarin e mbledhjeve për vitin 2024.**

#### Pika 3

##### Raport i punës të KAKRS për vitin 2023

**Kryesuesja, znj. Albana Podvorica;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z. Asllan Beqaj;** Për pikat e drejtorive unë nuk jam për me i hjekë.

**\*Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport, unanimsisht miratoi raportin e punës për vitin 2023.**

#### Pika 4

##### Miratimi i planit të punës për vitin 2024

**Kryesuesja, znj. Albana Podvorica;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**znj. Arbenita Brahimi;** Unë propozoj që te muaji Mars pika e 4 dhe 5 me kalu në muajin Shkurt 2024. E kemi edhe festën e 17 Shkurtit.

**Kryesuesja, znj. Albana Podvorica;** Unë jam dakort që komplet muaji Mars me u transferu në muajin Shkurt 2024.

**z. Asllan Beqaj;** Pajtohem që Marsi me kalu në Shkurt e në mars me bërë vetëm vizita.

**\*Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport, unanimsisht miratoi planin e punës për vitin 2024 me propozimin që muaji Mars të kalojë në muajin Shkurt.**

#### Pika 5

##### Informate nga DKA rreth braktisjes së shkollës nga nxënësit

**Kryesuesja, znj. Albana Podvorica;** Hapi diskutimin për këtë pikë.

**z. Asllan Beqaj;** Gjatë vizitave në shkolla janë ankuar drejtorat për braktisjen e shkollave. Kjo pikë është e rëndësishme sepse po e braktisin shkollën shumë fëmijë si pasoj e shpërnguljes komplet të familjes. Propozoj me shty këtë pikë dhe me diskutu me drejtoreshën.

**\*Komiteti për Kulturë, Rini dhe Sport, unanimsisht vendosi që të shtyjë këtë pikë "Informate nga DKA rreth braktisjes së shkollës nga nxënësit" për mbledhjen e Shkurtit.**

#### Pika 6

##### Analizë nga DKA dhe DKRS rreth realizimit të punës dhe arritjes së objektivave për vitin 2023

**Kryesuesja, znj. Albana Podvorica;** Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Albana Fazliut.

**znj. Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS;** Përshëndetje unë nuk kamë përgaditur ndonjë raport për këtë pikë sepse kamë qenë e anagazhuar me aktivitete tjera të shumta.

**z. Asllan Beqaj;** Të përgëzojë për punën dhe aktivitetet sepse unë kamë qenë pjesëmarrës i tyre. Një sygjërim ta kisha dhënë për me i kushtu më shumë vëmendje në vitin 2024 për me bë diçka për sa i përket ikjes nga Kosova të nxënësve të rinjëve dhe familjeve.

**z. Arbenita Brahimi;** Unë desha ta pyes drejtoreshën për numrin e librave në Bibliotekë si dhe për numrin e lexuesve?

**znj. Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS;** Kemi një donacion nga MKRS-ja por ne po presim për përfundimin dhe inaugurimin së shpejti të Bibliotekës, sepse aty ka mbetur vetem plotesimi i inventarit.

**z. Rexhep Gashi;** Përshëndetje, kërkoj falje për vonesën, te cila pikë po diskutojmë?

**Kryesuesja, znj. Albana Podvorica;** Për pikën e fundit po diskutojmë. Drejtoreshë ne nuk duhet ta neglizhojmë këtë Komitet pavarësisht se a paguhemi, apo jo. Unë nuk po e di pse. Te Biblioteka sa lexues janë krejt?

**znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS;** Numrat këtu nuk i kamë, por mund t'i sigurojmë, se sa lexues janë, dhe ky numër mund të ndryshon varësisht nga rrethanat. Gjendja e tanishme e Bibliotekës është e mjerueshme.

**z.Asllan Beqaj;** Nese mundesh me na dërguar një raport të punës së DKRS-së për vitin 2023.

**z.Arbenita Brahimi;** Për Qendrën Rinore dhe Bibliotekën ke thënë do të renovohen deri ku keni mbërri me punët?

**znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS;** Për Bibliotekën pritet vetëm inventari, ndërsa për Qendrën Rinore pritet alokimi i mjeteve.

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Jam kritike për atë që me rininë, shumë pak jeni duke bërë. Po ballafaqohemi me sfida, çka po bëni ju më shumë si drejtori? Cilat kanë qenë kriteret për ndarjen e subvencioneve?

**znj.Albana Fazliu, drejtoresh e DKRS;** Kriteret janë të definuara në rregulloren që e keni miratuar ju si Kuvend. Për Rini jemi duke punuar, nuk është që nuk po punojmë. Ka aktivitete të ndryshme që mund të angazhohen të rinjët.

**z.Asllan Beqaj;** A po merret dikush me dukuritë negative në shkolla?

**Kryesuesja, znj.Albana Podvorica;** Meqenëse diskutime të tjera nuk kishte, Kryesuesja mbledhjen e përfundoi në ora 09:46h.

Procesmbajtës  
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e Komitetit  
Albana Podvorica

